



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

**VLERËSIMI I ZBATIMIT
TË REKOMANDIMEVE
TË RAPORTEVE TË AUDITIMIT
TË PERFORMANCËS TË VITIT (2019)**

Prishtinë, gusht 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me raportin e auditimit për vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve "Vlerësimi i rekomandimeve të auditimit të performancës (2019), në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshme Myrvete Gashi-Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Ariana Gjonbalaj, Drejtor i Auditimit
Vjosë Bojku, Udhëheqës i ekipit
Lindita Dautaj, antare e ekipit
Lirak Mulliqi, antarë ekipi

¹ Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

³ Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme	5
1. Hyrje.....	8
2. Objektiva e vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	9
Pyetjet e auditimit	9
3. Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve në raportet e auditimit të performancës për vitin 2019	10
3.1 Mungesa e Letër-Konfirmimeve	10
3.2 Mungesa e Planit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Subjektet e Audituarat ...	11
4. Vlerësimi i ndikimit të auditimeve dhe niveli i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve.....	13
4.1 Zbatimi i rekomandimeve në nivel të raporteve individuale dhe subjekteve të audituara	15
4.3 1. Vlerësimi i institucioneve të audituara pa plane të veprimit dhe ndryshimet e evidentuara	25
5. Konkluzionet	29
Shtojca I. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia....	30
Motivi i Auditimit.....	30
Pyetjet e auditimit	30
Kriteret e auditimit:.....	31
Metodologjia e Auditimit.....	31
Fushëveprimi dhe kufizimet e këtij auditimi	32
Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant.....	34
Shtojca II. Tabela me rekomandimet për të cilat nuk kemi marrë përgjigje/kufizim fushëveprimi	36

Shkurtesat

AK - Autoritet Kontraktues

ARRU - Autoriteti Rregullativ i Ujërave

AUV - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

Dogana - Dogana e Kosovës

DT - Dosje e Tenderit

MAP - Ministria e Administratës Publike

MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MF - Ministria e Financave

MIT - Ministria e Infrastrukturës Dhe Transportit

MKRS - Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

OE - Operator Ekonomik

PK - Policia e Kosovës

SKQZ - Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

ZKM - Zyra e Kryeministrit

ZRRE - Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit në vitin 2019 ka publikuar 13 raporte të auditimit të performancës. Qëllimi i këtyre raporteve të auditimit të performancës ishte të vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet dhe aktivitetet veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim.

Zyra Kombëtare e Auditimit në këtë raport të vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve ka përfshirë 199 rekomandime të dhëna në 10 raporte të auditimit të performancës, për 36 subjekte të cilat ishin të përfshira në këto auditime. Gjatë procesit të vlerësimit të rekomandimeve kemi vizituar 30 nga këto subjekte, ku disa prej tyre ishin pjesë e më shumë se sa një raport auditimi.

Gjatë vitit 2019, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar vetëm një raport të auditimit të performancës nga gjithsej 13 raporte të publikuara. Raport i shqyrtuar ishte: "Procesi i Menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në Sektorin e Bujqësisë". Duke pasur parasysh se publikimi i këtyre është bërë gjatë periudhës së pandemisë, kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e aktivitetit parlamentar. Si rezultat, nga gjithsej 130 raporte të dërguara në Kuvendin e Republikës së Kosovës vetëm 37 janë shqyrtuar nga komisioni parlamentar përkatës.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka përgatitur dhe dërguar pyetësor për dhjetë raporte të auditimit të cilat janë dërguar tek subjektet të cilat kishin dërguar planin për zbatim të rekomandimeve. Përgjigje në pyetësorë kemi pranuar nga të gjitha subjektet e përfshira në këtë vlerësim. Lista me subjektet për auditimet e performancës që nuk na janë përgjigjur kërkesave tona për zbatim të rekomandimeve është paraqitur në shtojcën II të këtij raporti. Kryesisht kjo ka ndodhur për raportet e auditimit të performancës: "Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit" si dhe raporti "Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje" ku kemi pranuar përgjigje pjesërisht nga subjektet e audituara.

Zbatimi i disa rekomandimeve në nivel individual nga subjektet e audituara ka ndikuar pozitivisht në adresimin e disa prej mangësive të evidentuara gjatë auditimit, duke kontribuar në një përmirësim të pjesshëm të gjendjes së mëparshme. Megjithatë, përpjekjet e përgjithshme për zbatimin e rekomandimeve vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme dhe të ngadalta. Duhet theksuar se rekomandimet janë dhënë që në vitin 2019 një periudhë sfiduese për shkak të pandemisë së COVID-19, gjatë së cilës shumica e institucioneve operonin me kapacitete të reduktuara dhe staf esencial. Megjithatë, kalimi i një periudhe gjashtëvjeçare që nga dhënia e tyre konsiderohet kohë e mjaftueshme për të marrë masa konkrete dhe për të ndërmarrë veprime të qëndrueshme drejt zbatimit të plotë të rekomandimeve. Mospërmbushja e tyre në këtë afat të gjatë ngre shqetësime lidhur me mungesën e përkushtimit institucional, dobësitë në sistemin e ndjekjes së rekomandimeve dhe mungesën e mekanizmave efektivë të llogaridhënies, të cilat mund të pengojnë përmirësimin e performancës dhe rritjen e efikasitetit në administrimin publik.

Mungesa e bashkëpunimit me disa subjekte të audituara përmes mosdorëzimit të letër konfirmimeve dhe mospërgatitjes së planeve të veprimit, ka bërë të pamundur vlerësimin e progresit të rekomandimeve. Kjo situatë ka ndikuar negativisht në aftësinë për të monitoruar dhe matur përmirësimet e mundshme në performancën institucionale. Auditimet e realizuara në vitin 2019 kanë përfshirë një gamë të gjerë fushash me rëndësi strategjike për zhvillimin dhe funksionimin efikas të sektorit publik, përfshirë arsimin, energjinë, bujqësinë, ndërtimin, sigurinë rrugore, sigurinë ushqimore dhe prokurimin publik. Në këto auditime janë dhënë gjithsej 199 rekomandime, të cilat synonin adresimin e dobësive të identifikuara dhe përmirësimin e menaxhimit publik. Megjithatë, në disa raste nuk janë ndërmarrë masa konkrete për zbatimin e tyre, ndërsa për katër raporte të auditimit nuk janë hartuar fare plane të veprimit, gjë që dëshmon për mungesë angazhimi dhe përgjegjshmërie institucionale.

Vlerësimi i përgjithshëm i implementimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e performancës tregon një progres të kufizuar dhe sfida në zbatimin e tyre nga subjektet e audituara. Nga analiza e dhjetë raporteve të auditimit të performancës, rezulton se vetëm 25% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, ndërsa 55% e tyre ende nuk janë trajtuar dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për zbatimin e tyre. Për 4% të rekomandimeve është evidentuar progres i pjesshëm, pasi ato ndodhen në faza të ndryshme të zbatimit. Ndërkohë, për 16% të rekomandimeve nuk ka qenë e mundur të bëhet vlerësimi përkatës, për shkak të kufizimit të fushëveprimit si mungesë e përgjigjeve nga institucionet përkatëse. Këto të dhëna dëshmojnë për mungesën e përkushtimit institucional, të mekanizmave të monitorimit, si dhe llogaridhënies.

Gatishmëria e subjekteve të audituara për të bashkëpunuar në procesin pas-auditues, përmes dorëzimit të letër konfirmimit dhe planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, rezulton të ketë qenë e pamjaftueshme. Nga gjithsej 36 subjekte të audituara, vetëm 12 kanë dorëzuar letër-konfirmime duke reflektuar një nivel të ulët angazhimi institucional, plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve janë dorëzuar vetëm 12 subjektet e audituara, ndërsa për tre raporte të auditimit nuk është asnjë plan veprimi. Në pesë raste të tjera, planet e dorëzuara kanë qenë të pjesshme dhe jo të mjaftueshme për të siguruar një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme ndaj adresimit të rekomandimeve.

Mos përgatitja e dokumenteve përkatëse, siç janë planet e veprimit, dhe mosrespektimi i kërkesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit për të mundësuar vlerësimin e masave të ndërmarrë në lidhje me rekomandimet, dëshmojnë për një mungesë të theksuar të llogaridhënies nga ana e subjekteve të audituara. Mungesa e prioritizimit në zbatimin e rekomandimeve tregon se përmirësimi i performancës institucionale dhe menaxhimi efikas i parasë publike nuk po trajtohen me seriozitetin e nevojshëm. Kjo qasje joaktive jo vetëm që e vështirëson monitorimin e progresit, por gjithashtu zbeh efektivitetin e auditimeve të performancës si mekanizëm për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e qeverisjes publike. Megjithatë, vlen të theksohet se, ndonëse disa subjekte të audituara nuk kanë dorëzuar formalisht plane të veprimit, gjatë procesit të vlerësimin është vërejtur se janë ndërmarrë disa veprime konkrete për adresimin e çështjeve të identifikuara në raportet e auditimit. Kjo tregon

se, në disa raste, ekziston një përpjekje faktike për përmirësim, por që mungesa e dokumentimit dhe raportimit e bën të vështirë vlerësimin e plotë dhe të besueshëm të progresit të arritur.

Rekomandimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës:

Të ushtrojë rolin mbikëqyrës në mënyrë më aktive duke kërkuar llogaridhënie nga Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kuvendi duhet të sigurohet që institucionet përkatëse marrin masa konkrete për adresimin e gjetjeve të auditimit dhe të kërkojë raporte të rregullta mbi progresin e arritur në këtë drejtim.

Rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kryetarët e Komunave:

Të ndërmarrin veprime proaktive për adresimin e plotë dhe në kohë të të gjitha çështjeve të ngritura në raportet e auditimeve të performancës, duke vendosur mekanizma të qartë, funksionalë dhe të qëndrueshëm të llogaridhënies, me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës në menaxhimin publik. Në këtë drejtim, rekomandohet që:

- Subjektet e audituara, brenda 30 ditëve nga pranimi i raportit final të auditimit, të hartojnë dhe dërgojnë në Zyrën Kombëtare të Auditimit planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve; dhe
- Institucionet përkatëse t'u përgjigjen në kohë dhe në mënyrë të plotë kërkesave për dokumentacion mbështetës, të paraqitura nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si për nevojat e auditimit, ashtu edhe për proceset vlerësuese pas-auditimit.

1. Hyrje

Institucionet Supreme të Auditimit (ISA-të) luajnë rol jetik në kërkim të llogaridhënies nga Institucionet publike në raport me administrimin e fondeve publike. Përveç kësaj, këto të fundit ndihmojnë edhe në ngritjen e transparencës së aktiviteteve të qeverisë.

Qëllimi i vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve është t'u ofrojë informacione të pavarura Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe palëve të tjera të interesit lidhur me masat e ndërmarra nga subjektet e audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Përveç kësaj, vlerësimi shërben si një orientim për Zyrën Kombëtare të Auditimit në kuptimin e nivelit të zbatimit dhe ndikimit të saj përmes raporteve të auditimit të performancës.

Qëllimi kryesor i Zyrës Kombëtare të Auditimit nuk përfundon me publikimin e raportit të auditimit por me vlerësimin e ndikimit të aktivitetit auditues në përmirësimin e menaxhimit të parasë publike.

Pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, prej subjektit të audituar kërkohet që të hartoj një plan të veprimit ku specifikohen veprimet që do të ndërmeren, koha dhe mënyra e zbatimit të e rekomandimeve të dhëna.

Qëllimi i rekomandimeve në auditimet e performancës është përmirësimi i proceseve të ndryshme dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet u adresohen subjekteve të audituara dhe zbatimi i tyre shërben si mekanizëm për tejkalimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase, ekonomike dhe efektive në arritjen e objektivave.

Pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, aktivitetet përcjellëse kontribuojnë në zbatimin më efektiv të rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara. Synimi i vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve është që të përcaktohet nëse me veprimet e ndërmarra është shënuar progres në krahasim me gjendjen e konstatuar gjatë auditimeve.

Pasi që shumica e rekomandimeve të auditimit të performancës kërkojnë kohë për t'u zbatuar, vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të performancës duhet të ndërmerret pas një periudhe të caktuar kohore.

Përmes këtij raporti janë vënë në pah rezultatet në procesin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës. Në këtë mënyrë janë vlerësuar rezultatet e subjekteve në realizimin e objektivave në përputhje me parimet e menaxhimit efektiv.

2. Objektiva e vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve

Sipas standardeve të auditimit, vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është një proces i rëndësishëm për të monitoruar nëse subjektet e audituara kanë implementuar rekomandimet e dhëna. Pas publikimit të raporteve, është detyrë e subjekteve të dorëzojnë planet e veprimit dhe të sigurojnë se rekomandimet janë zbatuar në kohë dhe në mënyrë efektive, për të përmirësuar performancën dhe për të adresuar mangësitë e identifikuara.⁶

Objektivë e këtij auditimi është të kuptojmë pse disa nga institucionet e audituara nuk kanë dorëzuar letër konfirmimet dhe planet e veprimit sipas afatit kohor, të vlerësojmë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimeve të performancës të publikuara gjatë vitit 2019 si dhe nëse këto të fundit kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar përmes auditimit.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit, kemi formuluar pyetjet kryesore në vijim:

- 1. A janë dërguar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe a janë zbatuar rekomandimet nga subjektet e audituara? dhe**
- 2. A kanë arritur rekomandimet përmirësimin e gjendjes në subjektin e audituar?**

Ky vlerësim i nivelit të zbatimit të rekomandimeve për bazë kishte raportet e auditimit të performancës të publikuara në vitin 2019. Në këto auditime janë përfshirë 36 institucione publike, prej të cilave 12 i takojnë nivelit lokal (komunave), 22 të nivelit qendror (Ministri dhe Agjenci të pavarura) dhe dy ndërmarrje publike.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi, nën-pyetjet e auditimit kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i detajuar i auditimit janë paraqitur në Shtojcën 1.

⁶ SNISA 300, www.issai.org, Performance Audit Principles, INTOSAI Standards

3. Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve në raportet e auditimit të performancës për vitin 2019

Në këtë kapitull është paraqitur vlerësimi dhe ndikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës të publikuara gjatë vitit 2019. Fillimisht, është analizuar niveli i përgjithshëm i pajtueshmërisë së subjekteve të audituara me kërkesat e Zyrës Kombëtare të Auditimit, përmes shqyrtimit të letër-konfirmimeve dhe planeve të dorëzuara.

Më pas, është paraqitur një përmbledhje e përgjithshme e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e performancës, si dhe një analizë e detajuar për secilin raport individual dhe për secilin subjekt të audituar. Vlerësimi është bazuar në një qasje të kombinuar metodologjike, përfshirë analizën e pyetësorëve të dërguar institucioneve, shqyrtimin e përgjigjeve të marra dhe dëshmimeve përkatëse, si dhe takimeve dhe vizitave në terren. Gjithashtu, është paraqitur në mënyrë tabelare edhe niveli i ndikimit të auditimit, duke e ilustruar shkallën e zbatimit të rekomandimeve në formë të përmbledhur dhe vizuale.

Këto burime të integruara kanë ndihmuar në krijimin e një pasqyre të qartë dhe të besueshme mbi situatën aktuale në institucionet përkatëse, si dhe në vlerësimin e progresit real në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i performancës.

Po ashtu, në shtojcën II të këtij raporti janë përfshirë rekomandimet për të cilat ZKA-ja nuk ka marrë përgjigje nga subjektet e audituara, duke reflektuar një boshllëk në bashkëpunim dhe transparencë.

Megjithëse shumica e subjekteve të audituara kryesisht ishin pajtuar me gjetjet dhe rekoamndimet e ZKA-së, të cilat konfirmohen përmes letër konfirmimeve dhe planeve për zbatim të rekomandimeve, niveli i përgjithshëm i pajtueshmërisë dhe veçanërisht i zbatimit të rekomandimeve vazhdon të mbetet një sfidë thelbësore.

3.1 Mungesa e Letër-Konfirmimeve

Pas pranimit të draft raportit të auditimit të performancës, subjekti i audituar është i obliguar të dorëzojë leterkonfirmimin që pajtohet me gjetjet dhe rekomandimet që rrjedhin nga ky raport i auditimit si dhe zotimin që brenda një afati prej 30 ditësh do ta dërgojnë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve⁷.

Në 10 raportet e auditimit të performancës, ku ishin të përfshira gjithsej 36 subjekte të audituara, 24 prej tyre kishin dërguar me kohë letër konfirmimet, ndërsa 12 subjekte nuk kishin dorëzuar fare një përgjigje të tillë. Mungesa e letër-konfirmimeve ishte më e theksuar tek Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjise (tutje MASHT) e cila ishte subjekt auditimi në katër raporte auditimi, si dhe tek Ministria e Infrastruktues (tutje MI). Nga komunat,

⁷ ISSAI 3000 – Standardet Ndërkombëtare për Auditimin e Performancës

vetëm Komuna e Istogut ka dërguar letër konfirmimin brenda afatit të përcaktuar, perderisa gjashtë⁸ komuna tjera nuk kane dorëzuar fare.

Mosdorëzimi i letër-konfirmimeve është justifikuar me arsye të ndryshme, përfshirë ndikimin e pandemisë COVID-19, ndryshimi i menaxhmentit të institucioneve dhe zyrtarëve të përfshirë në proces, si dhe mungesa e informacionit lidhur me auditimin e performances. Këto faktorë kanë ndikuar negativisht në vazhdimësinë institucionale dhe përgjegjshmërinë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Mungesa e një letër-konfirmimi, nga subjekti i audituar nuk ofron siguri të mjaftueshme për nivelin e pajtueshmërisë me gjetjet dhe rekomandimet e raportit të auditimit. Në këto raste, bëhet e vështirë të vlerësohet nëse institucioni ka pranuar gjetjet dhe është i angazhuar në zbatimin e rekomandimeve, gjë që ndikon në vlerësimin e përgjithshëm të progresit në implementim.

3.2 Mungesa e Planit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Subjektet e Audituar

Pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, subjekti i audituar është i obliguar të dorëzojë një plan të shkruar veprimi ku specifikohen afatet kohore dhe mënyra se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna. Ky plan veprimi pasqyron gatishmërinë e subjekteve të audituara që të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre, për të zbatuar rekomandimet dhe si rrjedhojë të përmirësojnë aktivitetet apo programet e tyre qeveritare⁹.

Në tabelën e mëposhtme janë shpalosur raportet e auditimit dhe informatat e përgjithshme se për cilat raporte janë dorëzuar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

⁸ Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Ferizaj, Vushtrri, Suharek dhe Mitrovicë

⁹ Manuali i Auditimit të Performancës kapitulli Percjellja e rekomandimeve të raportit auditues.

Tabela 1. Dorëzimi i planeve të veprimit për raportet e auditimit të performancës

	<i>Raporti i Auditimit</i>	<i>Plani i Veprimit</i>	
		Kanë dorëzuar të gjitha OB ose pjesërisht	Nuk kanë dorëzuar
1	<i>Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020 në sektorin e arsimit dhe infrastrukturës</i>	√ ¹⁰	
2	<i>Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjetës</i>	√	
3	<i>Siguria në trafikun rrugor</i>	√ ¹¹	
4	<i>Siguria e Ushqimit – Rast studimi: produktet e mishit dhe të gurit</i>	√	
5	<i>Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore</i>		√
6	<i>Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit</i>		√
7	<i>Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve</i>	√	
8	<i>Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje</i>		√
9	<i>Procesi i menaxhimi të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë</i>	√ ¹²	
10	<i>Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë</i>	√ ¹³	

Nga analiza e tabelës vërehet se, nga gjithsej 199 rekomandime të dhëna në 10 raportet e auditimit të performancës, për 75 rekomandime janë dorëzuar pjesërisht planet e veprimit, që nënkupton se jo të gjitha subjektet e audituara kanë dorëzuar plane për zbatim. Ndërkohë, për 52 rekomandime nuk janë dorëzuar fare plane nga subjektet përkatëse. Vlen të theksohet se vetëm për 48 rekomandime në raportet: “*Siguria e Ushqimit – Rast studimi: produktet e mishit dhe të gurit*”¹⁴ dhe “*Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve*”¹⁵, janë dërguar planet e veprimit nga të gjitha entitetet e përfshira në auditim.

Për sa i përket raporteve, pesë prej tyre kanë dorëzuar plane të veprimit vetëm pjesërisht, katër raporte që përfshijnë 19 entitete nuk kanë dorëzuar fare plane të veprimit, ndërsa vetëm dy raporte janë mbështetur plotësisht me plane të veprimit nga institucionet e audituara.

Sfidat me pandeminë COVID 19, ndryshimet në entitetet si ndërrimi i menaxhimentit, mungesa e një strategjie të qartë për zbatimin e rekomandimeve si dhe mangësitë në menaxhimin e brendshëm të institucioneve, ka ndikuar që subjektet e audituara të mos angazhohen plotësisht për të dorëzuar planet e veprimit.

¹⁰ Ministria e Financave, mungon nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

¹¹ Ministria e Punëve të Brendshme, mungon nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit si dhe nga Komuna e Prishtinës.

¹² Zyra e Kryeministrit e ka dorëzuar planin ndërsa mungojnë planet e veprimit nga MBPZHR si dhe komunat: Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj.

¹³ Planet e veprimit janë dorëzuar nga Dogana e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndërsa MASHT nuk ka dorëzuar plan të veprimit.

¹⁴ Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës dhe

¹⁵ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Dogana e Kosovës

Mungesa e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve e bën të pamundur monitorimin dhe ndjekjen sistematike të progresit në zbatim. Kjo pamundësi ndikon negativisht në përmirësimin e performancës institucionale dhe shkakton vonesa në adresimin e mangësive të identifikuar nga auditimi. Si rezultat, rrezikohet efektiviteti i procesit të auditimit dhe kufizohet ndikimi i tij në zhvillimin dhe përmirësimin e institucioneve të audituara.

4. Vlerësimi i ndikimit të auditimeve dhe niveli i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve

Në këtë kapitull, kemi paraqitur vlerësimin e ndikimit të auditimeve të performancës dhe nivelin e përgjithshëm të zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Fillimisht, përmes një tablele të strukturuar, është paraqitur një pasqyrë e qartë e ndikimit të auditimit në institucionet përkatëse, duke u bazuar në disa elemente kyçe: ndryshimet e konstatuara pas auditimit, numri i rekomandimeve që janë zbatuar plotësisht dhe burimet e ndikimit që kanë ndikuar në përmirësimet e arritura. Ky vlerësim kombinon të dhëna sasiore dhe cilësore për të reflektuar në mënyrë sa më reale efektin e auditimeve, si dhe për të identifikuar faktorët që kanë kontribuar në arritjen ose mungesën e progresit në secilin institucion të audituar. Pasqyra e krijuar synon të ndihmojë në kuptimin e ndikimit të drejtpërdrejtë të procesit të auditimit, por edhe të sfidave që lidhen me zbatimin efektiv të rekomandimeve në praktikë.

Tabela 2. Vlerësimi i ndikimit të rekomandimeve

Institucioni Përgjegjës	Nr Rekomandimeve të Zbatuara	Ndryshimi i Konstatuar	Burimi i Ndikimit
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	14	Mbikëqyrje më e mirë, plane inspektimi, bashkëpunim ndër-institucional	Auditimi
Dogana e Kosovës, MTI	16	Pajisje laboratorike të reja, rritje e kapacitetit të testimit	Auditimi
Ministria e Financave	4	Hartim më cilësor i KASH, komunikim më i mirë me OB-të	Auditimi
Policia e Kosovës	5	Regjistrim i përmirësuar, plane patrullimi, analiza trafiku	Auditimi
Zyra e Kryeministrit	2	Mekanizma monitorimi, harmonizim programesh	Auditimi
Dogana, MPB, SKQZ	6	Analiza tregu, rregulla të përmirësuara të prokurimit	Auditimi + politika
MAP, MKRS	3	Memorandume më të qarta, penalizim i OE	Auditimi
MAShT, Komuna e Ferizajt, Vushtrri	6	Udhëzues të rinj, investime, praktika të mira	Auditimi + veprime komunale

Të dhënat e paraqitura në tabelë dëshmojnë se në fushën e sigurisë ushqimore, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka ndërmarrë veprime të rëndësishme si rezultat i auditimit. Si rrjedhojë është përmirësuar dukshëm sistemi i mbikëqyrjes, janë zbatuar planet e inspektimit si dhe është forcuar bashkëpunimi ndërinstytucional, për të mbuluar më mirë zinxhirin ushqimor.

Në sektorin e tregtisë dhe doganave, rekomandimet e auditimit kanë ndikuar në rishikimin e planifikimeve dhe kanë shërbyer si pikënisje për investime të drejtuara në laboratorë bashkëkohorë dhe pajisje të avancuara teknologjike. Këto investime janë thelbësore për forcimin e kontrollit të cilësisë së derivateve të naftës dhe produkteve të tjera të ndjeshme ndaj standardeve.

Në fushën e financave publike, ndikimi i auditimit është reflektuar në procesin e hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) nga Ministria e Financave. Gjetjet e auditimit kanë vënë në pah dobësitë në planifikimin afatmesëm dhe koordinimin ndërinstytucional, çka ka nxitur Ministrinë të ndërmarrë masa për përmirësimin e këtij procesi. Si rezultat janë përdorur analiza më të detajuara dhe është forcuar komunikimi me organizatat buxhetore, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit buxhetor.

Po ashtu, në fushën e sigurisë publike, Policia e Kosovës, si subjekt auditimi, ka ndërmarrë masa për përmirësimin e menaxhimit të burimeve, bazuar në rekomandimet e auditimeve të mëparshme. Janë ndërmarrë hapa për modernizimin e sistemit të regjistrimit të të dhënave, përmirësimin e planifikimit të patrullimeve sipas analizës së rrezikut, dhe përdorimin e të dhënave për analiza të sofistikuara të trafikut.

Zyra e Kryeministrit ka ndërmarrë hapa konkretë drejt zhvillimit të mekanizmave të monitorimit dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në harmonizimin e programeve ndërsektoriale, si përgjigje ndaj rekomandimeve të auditimit. Këto përmirësime kanë synuar rritjen e koordinimit institucional dhe efektivitetit në zbatimin e politikave publike, veçanërisht në fushën e bujqësisë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe komuna të caktuara si Ferizaj dhe Vushtrri, kanë reaguar pozitivisht ndaj gjetjeve duke ndërmarrë masa konkrete për përmirësim. Edhe pse nuk kemi plan të veprimit për zbatim të rekomandimeve nga komunat përkatëse janë ndërmarrë veprime të tilla si përditësimi i udhëzuesve operativë, rritja e investimeve në infrastrukturën shkollore, dhe zbatimi i praktikave të mira në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shkollave publike.

Ndikimi i auditimit ka qenë më i lartë në ato institucione që kanë pasur plane veprimi siç janë rasti i Doganës së Kosovës dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Në rastet kur mungojnë plane konkrete ose kur zbatimi varet nga faktorë të jashtëm, ndikimi ka qenë më i kufizuar si në rastin e Ministrisë së Financave (KASH). Gjithashtu, në disa raste ndikimi ka rezultuar i kombinuar nga auditimi dhe politikat si të Doganat dhe Ministria e Punëve të Brendshme apo MASHT dhe komunat përkatëse, ku përmirësimet janë ndikuar si nga rekomandimet e auditimit, ashtu edhe nga ndërhyrje të tjera institucionale.

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2019 përfshijnë fushat si: arsimi, energjinë dhe shërbimet komunale, transportin dhe sigurinë rrugore, sigurinë ushqimore, qeverisjen lokale dhe projektet me financim nga donatorët, ndërtimin dhe infrastrukturën publike, bujqësinë dhe zhvillimin rural, mjedisin (me fokus në kontrollin e cilësisë së derivateve), politikëbërjen dhe administratën publike, si dhe prokurimin publik. Tabela në vijim paraqet numrin e rekomandimeve të dhëna në këto fusha dhe ecurinë e zbatimit të tyre nga subjektet e audituara.

Tabela 3 Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve

Statusi i Rekomandimit	Numri i rekomandimeve
Është zbatuar	51
Eshtë në fazën finale të zbatimit	2
Është filluar me zbatim	3
Nuk është filluar me zbatim	111
Nuk është adresuar	0
Nuk është i aplikueshëm	1
Nuk kemi pranuar përgjigje	31
	199

Tabela e paraqitur tregon se një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të auditimit të performancës për vitin 2019 ende nuk janë trajtuar. Konkretisht, rreth 55% e rekomandimeve nuk kanë filluar së zbatuari, ndërsa vetëm 25% janë zbatuar plotësisht. Për një pjesë të vogël të tyre rreth 4% janë në faza të ndryshme të zbatimit. Ndërkohë, për 16% të rekomandimeve nuk ka pasur përgjigje nga subjektet e audituara, duke pamundësuar vlerësimin e progresit në këto raste.

Moszbatimi i këtyre rekomandimeve pasqyron mungesën e angazhimit të mjaftueshëm institucional për përmirësim të vazhdueshëm. Kjo situatë rrit rrezikun që dobësitë sistematike të identifikuara të mbesin të paadresuara, duke ndikuar negativisht në efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike.

4.1 Zbatimi i rekomandimeve në nivel të raporteve individuale dhe subjekteve të audituara

Në një periudhë të arsyeshme kohore pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, subjekti i audituar duhet të sigurojë progres në përputhje me zotimet në plan të veprimit¹⁶.

Në vijim, do të paraqesim zbatimin e rekomandimeve për secilin raport të auditimit të performancës, të ndarë sipas shkallës së përgatitjes së planeve të veprimit:

- raporte të mbështetura plotësisht me plane të veprimit,
- raporte me plane të pjesshme, dhe
- raporte për të cilat nuk janë dorëzuar fare plane të veprimit.

Raportet e auditimit me plane të veprimit

Nga 10 raportet e auditimit që përfshijnë gjithsej 199 rekomandime, vetëm për 48 rekomandime, përkatësisht në dy raporte, janë dorëzuar plane të veprimit nga të gjitha

¹⁶ SNISA 3200, faqe 34/35,

entitetet e përfshira në auditim. Raportet e auditimit të cilat kanë plane të veprimit të plota janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 4 Raportet e auditimit të cilat janë të mbështetura tërësisht me plane të veprimit

	<i>Raporti i Auditimit</i>	<i>Plani i Veprimit</i>
1	<i>Siguria e Ushqimit – Rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit</i>	√
2	<i>Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve</i>	√

Në raportin “*Siguria e Ushqimit – Rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit*” janë dhënë 15 rekomandime. Nga këto, një rekomandim – konkretisht rekomandimi numër katër – është vlerësuar si i paaplikueshëm për shkak të rrethanave që nuk e lejojnë zbatimin e tij në praktikë.

Rekomandimi 4: Të ndërmerren veprime në bashkëpunim me komunat për të siguruar mbulimin me kontrole të të gjithë zinxhirit ushqimor, duke siguruar edhe mbikëqyrjen e tregut të kafshëve dhe të gjelbër në secilën komunë;	Nuk është i aplikueshëm
---	-------------------------

Ky rekomandim ka qenë specifikisht për Inspektoratin Sanitar i cili në atë kohë funksiononte në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV). Megjithatë, pas kalimit të këtij Inspektorati nën përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë (tutje MSh) vlerësimi i zbatimit të këtij rekomandimi nuk ishte më i mundur. Ndërkohë, 14 rekomandimet e mbetura janë zbatuar në përputhje me zotimet e paraqitura nga AUV në planin për zbatim të rekomandimeve. Në raportin e auditimit “*Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve*” subjektet e audituara ishin Ministria e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Dogana e Kosovës. Në total janë dhënë 22 rekomandime prej të cilave 15 i ishin adresuar Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (tutje MTI) dhe shtatë Doganës së Kosovës.

Nga 15 rekomandimet e adresuara MTI-së:

- **9 janë zbatuar,**
- **5 nuk kanë filluar ende me zbatim, dhe**
- **1 rekomandim është vlerësuar si i paaplikueshëm.**

Ndërkohë, Dogana e Kosovës ka zbatuar të gjitha shtatë rekomandimet në përputhje me zotimet e dhëna në planin për zbatimin e tyre. Për më tepër, janë evidentuar përmirësime konkrete, siç është shtimi i numrit të pajisjeve për testimin e derivateve, duke reflektuar angazhim për përmirësim të vazhdueshëm.

Foto 1. Pajisja për përcaktimin e sulfurit në përqendrime të ulëta

Dogana e Kosovës ka zbatuar të gjitha shtatë rekomandimet, në përputhje me zotimet e dhëna në planin për zbatimin e tyre. Përveç kësaj, janë evidentuar përmirësime konkrete në kapacitetet teknike, si rezultat i pajisjes së re të instaluar për matjen e përqendrimeve të ulëta të sulfurit në derivate. Kjo pajisje ka zëvendësuar një pajisje të vjetër që ishte në përdorim për rreth 14 vjet, dhe përfaqëson një avancim të konsiderueshëm teknologjik, duke përfshirë autosampler dhe nivel të lartë të saktësisë, përsëritshmërisë (repeatability) dhe riprodhueshmërisë (reproducibility) së rezultateve.

**Foto 2. Pajisje për përcaktimin e hidrokarbureve policiklike aromatike në derivatin dizel**

Pajisja e re, e furnizuar pas vitit 2019 shërben për përcaktimin e hidrokarbureve policiklike aromatike në derivatin dizel. Ky përmirësim teknologjik kontribuon në rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së matjeve, duke mbështetur kontrollin më efektiv të cilësisë së derivateve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Foto 3. Gaz kromatografi

Pajisja e re, e furnizuar pas vitit 2019 përfaqëson një teknologji më bashkëkohore dhe është e vetmja e cila e bënë përcaktimin e 11 parametrave të derivatit benzinë, ashtu siç kërkohet



me udhëzim dhe standard¹⁷. Ky avancim teknologjik siguron analizë më të saktë dhe të plotë të cilësisë së derivateve, duke përmirësuar kontrollin dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Raportet e auditimit me plane të pjesëshme për zbatimin e rekomandimeve

Nga 10 raportet e auditimit, katër prej tyre kanë plane të pjesëshme për zbatimin e rekomandimeve. Kjo tregon se, ndonëse për secilin raport është hartuar një plan veprimi, jo të gjitha rekomandimet janë përfshirë, pasi disa nga entitetet e auditurara nuk kanë dorëzuar planet e tyre.

Këto raporte janë paraqitur në tabelën numer 5.

¹⁷ UA 01/2017 dhe standardit EN 228

Tabela 5. Raportet e auditimit që kanë plane të pjesëshme për zbatimin e rekomandimeve

	<i>Raporti i Auditimit</i>	<i>Plani i Veprimit</i>
1	<i>Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020 në sektorin e arsimit dhe infrastrukturës</i>	√ ¹⁸
2	<i>Siguria në trafikun rrugor</i>	√ ¹⁹
3	<i>Procesi i menaxhimi të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë</i>	√ ²⁰
4	<i>Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë</i>	√ ²¹

Në vijim prezantojmë gjendjen e secilit raport të paraqitur më lartë.

“Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020 në sektorin e arsimit dhe infrastrukturës”
Ky auditim përfshinte gjithsej 10 rekomandime dhe ishte fokusuar në katër institucione: Zyra e Kryeministrit me dy rekomandime, Ministria e Financave (tutje MF) me katër rekomandime, Ministria e Infrastrukturës (tutje MI) dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me katër rekomandime (tutje MASHT).

Nga të katër subjektet e audituara vetëm MF kishte dorëzuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Megjithatë, Zyra e Kryeministrit, MASHT dhe MI kanë shënuar njëfarë progresi në krahasim me gjendjen e konstatuar në periudhën e auditimit. Ky përmirësim, ndonëse jo i lidhur drejtpërdrejt me një plan formal të zbatimit, mund të konsiderohet si rezultat i zbatimit indirekt të rekomandimeve të ZKA-së, duke qenë se të tri institucionet janë të përfshira në procesin e hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, i cili udhëhiqet nga Ministria e Financave.

Katër rekomandimet e dhëna për Ministrinë e Financave të cilat janë zbatuar janë:

Rekomandimi 1: Gjatë hartimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të identifikoj nivelin e zbatimit të projekteve/objektivave strategjike në mënyrë që të hartoj dhe aprovoj KASH i cili është i bazuar në analiza të detajuara dhe të arsyeshme. Po ashtu, të hartoj/zbërthej KASH edhe në nivel ministror në mënyrë që të siguroj transparencë lidhur me objektivat strategjike për secilin institucion.	I zbatuar
--	-----------

¹⁸ Ministria e Financave, mungon nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

¹⁹ Ministria e Punëve të Brendshme, mungon nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit si dhe nga Komuna e Prishtinës.

²⁰ Zyra e Kryeministrit e ka dorëzuar planin ndërsa mungojnë planet e veprimit nga MBPZHR si dhe komunat: Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj.

²¹ Planet e veprimit janë dorëzuar nga Dogana e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndërsa MASHT nuk ka dorëzuar plan të veprimit.

<p>Rekomandimi 2: Ris komunikimin me organizatat buxhetore gjatë procesit buxhetor në mënyrë që të siguroj një planifikim të mirëfilltë të objektivave strategjike si në aspektin financiar dhe atë të zbatimit të projektit. Gjatë analizimit dhe aprovimit të kërkesave të organizatave buxhetore si në KASH ashtu edhe në ligjin për ndarje të buxhetit, të siguroj se kërkesat bazohen në analiza të detajuara dhe të mjaftueshme dhe mbështeten me dokumentet relevante.</p>	I zbatuar
--	-----------

<p>Rekomandimi 3 : Projekt propozimet për investime kapitale të përmbajnë të gjitha informatat e kërkuara sipas Programit për Investime Publike dhe kërkesave aktuale.</p>	I zbatuar
---	-----------

<p>Rekomandimi 4 : KASH dhe ligji për ndarje buxhetore duhet të përfshijë projektet të cilat janë në harmoni me objektivat strategjike të planifikuara në SKZH dhe dokumentet tjera strategjike. Me theks të veçantë, duhet të siguroj se aprovohen vetëm projektet të cilat janë në përgjegjësi dhe kompetencë të organizatave buxhetore.</p>	I zbatuar
---	-----------

“Siguria në trafikun rrugor” - Ky auditim përfshinte gjithsej 24 rekomandime dhe ishte fokusuar në tre subjekte: Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (tutje MIT) me 10 rekomandime, Policia e Kosovës me tetë rekomandime dhe Komuna e Prishtinës me gjashtë rekomandime.

MIT si dhe Komuna e Prishtinës nuk kanë dorëzuar planet për zbatim të rekomandimeve. Megjithatë, MIT pas takimeve na është përgjigjur me dokumente lidhur me ndryshimet pozitive në entitet, kurse Komuna e Prishtinës pavarësisht faktit që në takim ishte zotuar se situata me sigurinë në rrugë është përmirësuar ndjeshëm, veçanërisht në aspektin e sinjalizimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, nuk ka ofruar dëshmi për të mbështetur këto pohime.

Pasqyra e rekomandimeve në Policinë e Kosovës është paraqitur në vijim:

<p>Rekomandimi 1: Të bëjë regjistrimin e plotë dhe me kohë të të dhënave në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës, duke bërë unifikimin e tij, në mënyrë që Policia e Kosovës të identifikoj qartë faktorët dhe shkaktarët e aksidenteve. Hartimi i raporteve dhe planifikimi i resurseve për të ofruar siguri në trafikun rrugor përmes kontrolleve policore, të bazohet në të dhënat e detajuara me faktorë dhe shkaktarë të aksidenteve të regjistruara në këtë sistem .</p>	I zbatuar
---	-----------

<p>Rekomandimi 2: Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor - Prishtinë të siguroj mbulimin e të gjitha regjioneve/segmenteve rrugore me kontrolle policore dhe brenda tyre të orientoj kontrollet policore duke u fokusuar në rrugët me rrezikshmëri të lartë. Të caktoj qartë dhe saktë vendin ku duhet të kryhen kontrollet në oraret kontrolluese dhe në planet e punës të evidentoj shfrytëzimin e pajisjeve (radarëve dhe alkool testeve); përforcimi i kontrolleve rrugore nga ana e policisë jo vetëm në pika statike, por duke aplikuar edhe monitorimin në lëvizje të përdoruesve të rrugës dhe përmes aplikimit teknologjive të reja të sigurisë rrugore.</p>	I zbatuar
<p>Rekomandimi 3: T'i kushtohet rëndësi më e madhe rritjes së nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit për siguri rrugore me anë të shërbimeve këshillimore dhe inkurajimit të përdoruesve të rrugës që të respektojnë normat ligjore si dhe kontrolle më të shpeshta të gjendjes dhe pajisjeve të sigurisë të cilat duhet t'i kenë mjetet.</p>	I zbatuar
<p>Rekomandimi 4: Sensibilizimin e ngasësve që të evitohen shpejtësitë e mëdha, të vendoset rripi i sigurisë, të evitohet përdorimi i telefonit gjatë vozitjes, përdoruesit e motoçikletave të bartin helmetën mbrojtëse, vozitësit profesional të automjeteve të rënda të respektojnë orët e vozitjes dhe të pushimit si dhe të përdorin tahografët digjital etj.</p>	Pjesërishtë i zbatuar
<p>Rekomandimi 5: Të shqyrtojë aplikimin e alternativave tjera siç është vendosja e kamerave përcjellëse dhe atyre statike për matjen e shpejtësisë nëpër rrugët rajonale dhe lokale në mënyrë që të rrisë sigurinë në trafikun rrugor.</p>	I pa zbatuar
<p>Rekomandimi 6: Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor - Prishtinë të fokusohet në aktivitetet e saj kryesore në trafik siç është parandalimi i aksidenteve dhe pastaj përmes një planifikimi më të mirë, të angazhohet në aktivitetet tjera dytësore.</p>	I zbatuar

Rekomandimi 7: Divizioni i Komunikacionit Rrugor të hartojë dhe zbatojë plane dhe të përgatisë raporte të mbikëqyrjes në baza të rregullta tre mujore përgjatë gjithë vitit.	I pa zbatuar
---	--------------

Rekomandimi 8: Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor - Prishtinë të përfshijë në planin vjetor të punës procesin e mbikëqyrjes së njësive kontrolluese nga menaxhmenti dhe të sigurojë implementimin e tij. Të bëhen plane të inspektimit nga udhëheqësi i Njësies Rajonale të Komunikacionit Rrugor Prishtinë dhe udhëheqësi i operativës. Të bëhet monitorimi i realizimit/implementimit të planeve operative kontrolluese policore nga mbikëqyrësi i parë i ekipeve patrulluese, po ashtu të sigurohet mbikëqyrja ndaj mbikëqyrësit të parë.	I zbatuar
--	-----------

“Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë” - Ky auditim kishte gjithsej 30 rekomandime dhe ishte fokusuar në institucionet si në vijim: Zyra e Kryeministrit me dy rekomandime, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me 11 rekomandime, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (tutje AZhB) me dy rekomandime, Komuna e Prishtinës me pesë rekomandime, Komuna e Prizrenit me pesë rekomandime dhe Komuna e Ferizajit me pesë rekomandime. Plan për zbatim të rekomandimeve ka dërguar vetëm Zyra e Kryeministrit (tutje ZKM).

Dy rekomandimet e dhëna ZKM-së janë zbatuar në përputhje me zotimin që është bërë në planin e veprimit. Këto rekomandime janë si më poshtë:

Rekomandimi 1: Të vendos mekanizma monitorimi për përcjelljen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe programeve qeveritare për të siguruar se ato janë duke u zbatuar nga institucionet përgjegjëse dhe për të matur rezultatet e arritura; dhe	I zbatuar
--	-----------

Rekomandimi 2: Të siguroj që programet afatgjata të kalojnë procedurat e aprovimit në të gjitha nivelet duke siguruar që ato janë në pajtim me synimet e qeverisë	I zbatuar
--	-----------

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe komunat Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj na kanë siguruar dëshmi për ndryshimet që janë bërë pas publikimit të raportit. Megjithatë, këto ndryshime pozitive nuk janë konfirmuar si rezultat i drejtpërdrejtë auditimit, por si rezultat i politikave të reja. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë nuk i është përgjigjur kërkesave/thirrjeve tona për takim, çka ka pamundësuar vlerësimin më të plotë të masave të ndërmarra.

Gjithashtu, buxheti për këtë kategori në këto gjashtë vite është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Sidomos në vitin 2022, Qeveria e Kosovës alokoi mbi 70 milionë euro për mbështetje direkte të fermerëve, duke përfshirë pagesa për subvencione dhe kompensim për dëmet nga fatkeqësitë natyrore. Kjo ishte mbështetje rekord për sektorin bujqësor në këtë periudh kohore.

“Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë” - Ky auditim kishte gjithsej 24 rekomandime dhe ishte përqendruar në katër institucione si në vijim: Dogana e Kosovës me gjashtë rekomandime, Ministria e Punëve të Brendshme (tutje MPB) me gjashtë rekomandime, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me gjashtë rekomandime, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (tutje SKQZ) me gjashtë rekomandime. Plane të veprimit për zbatim të rekomandimeve na kanë dërguar Dogana e Kosoves, MPB, dhe SKQZ, ndërsa MASHT nuk ka dërguar plan të veprimit. Pasqyra e rekomandimeve për Doganën e Kosovës, MPB dhe SKQZ është paraqitur më poshtë.

Rekomandimet e ZKA	Dogana e Kosovës	MPB	SKQZ
Rekomandimi 1: Të zhvillojnë hulumtim të tregut për të identifikuar furnitorët potencial, për të njohur kapacitetet e tyre profesionale.	Është filluar me zbatim.	Është në fazën finale të zbatimit.	Është filluar me zbatim.
Rekomandimi 2: Të zhvillojnë hulumtim të tregut për të identifikuar produktet/shërbimet që i ofron tregu në mënyrë që të hartojnë ST për produkt/shërbim që gjendet në treg dhe që i përgjigjet nevojave të AK-së.	Është në fazën finale të zbatimit	Është në fazën finale të zbatimit.	Është filluar me zbatim.
Rekomandimi 3: Të zhvillojnë një analizë të kontratave të zbatuara duke identifikuar kostot dhe përfitimet nga blerja në mënyrë që kjo analizë të shërbejë si pikë referimi për blerjet e ardhshme.	Është filluar me zbatim.	Është në fazën finale të zbatimit.	Është zbatuar.
Rekomandimi 4: Të hartojnë lista të furnitorëve potencial për prokurime të natyrave të ngjashme.	Është në fazën finale të zbatimit.	Është në fazën finale të zbatimit.	Është zbatuar.
Rekomandimi 5: Duke u shërbyer me listën e mësipërme, të aplikojnë procedurën konkurruese me negociata në rast se procedura e hapur nuk mund	Nuk është i aplikueshëm.	Është në fazën finale të zbatimit.	Është në fazën finale të zbatimit

të aplikohet për shkaqe objektivist të justifikueshme.			
Rekomandimi 6: Për prokurimet emergjente, kur procedura e negociuar pa publikim është e domosdoshme, të shërbehen me listën e furnitorëve në mënyrë që edhe procedura e negociuar të sigurojë konkurrencë.	Është në fazën finale të zbatimit.	Është në fazën finale të zbatimit.	Është zbatuar.

Raportet e auditimit që nuk kanë plane të veprimit

Për katër raportet e paraqitura më poshtë, me gjithsej 52 rekomandime, nuk janë hartuar fare planet e veprimit. Këto raporte përfshijnë fushat e sistemeve të përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike, termike dhe ujësjellësit, menaxhimin e mirëmbajtjes së institucioneve publike arsimore, menaxhimin e kontratave publike të ndërtimit dhe efektet e ndarjes së tenderëve në lloje.

Tabela 6. Raportet e auditimit të cilat nuk kanë plane të veprimit

	<i>Raporti i Auditimit</i>
1	<i>Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit</i>
2	<i>Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore</i>
3	<i>Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit</i>
4	<i>Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje</i>

Mungesa e planeve të veprimit tregon se ka një nevojë urgjente për përmirësim në këto fusha, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për funksionimin efektiv dhe efikas të institucioneve publike dhe menaxhimin e burimeve të shtetit.

Një analizë e detajuar për këto katër raporte të auditimit pa plane të veprimit e kemi paraqitur në kapitullin më poshtë.

4.3 1. Vlerësimi i institucioneve të audituara pa plane të veprimit dhe ndryshimet e evidentuara

Subjekti i audituar nuk kufizohet vetëm me zbatim të rekomandimeve, por mund të fokusohet në trajtimin e problemit në mënyrë adekuate dhe zgjidhje të problemeve pas një periudhe të arsyeshme²².

Ky kapitull paraqet vlerësimin e subjekteve të audituara që nuk kanë dorëzuar planet e veprimit me përjashtim të ZRRE-së dhe ARRU-së, të cilat i kanë dorëzuar ato, një aspekt i rëndësishëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve. Megjithëse, mungesa e planit të veprimit është një problem dhe pengesë për të kuptuar përmirësimet që janë bërë, procesi i auditimit ka vazhduar dhe ka bërë vlerësimin e gjendjes aktuale të subjekteve. Mungesa e bashkëpunimit nga disa subjekte të audituara ka paraqitur sfidë në vlerësimin objektiv të përmirësimeve.

Sistemi i përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike, termike dhe ujësjellësit

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nga ZKA, nuk është arritur të realizohet një takim me përfaqësuesit përkatës të autoriteteve të energjisë dhe ujit lidhur me raportin “Sistemi i përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike, termike dhe ujësjellësit”. Subjektet e Audituarat ishin: Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Ngrohtorja Qendrore Termokos Prishtinë, Ngrohtorja Qendrore Gjakova për tarifën e energjisë, ndërsa për tarifën e ujit Autoriteti Rregullativ i Ujit dhe tek ofruesit e shërbimeve KRU “Mitrovica”, KRU “Hidrodrini” Pejë dhe KRU “Hidroregjioni Jugor” Prizren.

Nga të gjitha institucionet e përmendura, ne kemi zhvilluar një takim vetëm me KRU “Mitrovica”. Meqenëse rekomandimet i adresohen Autoritetit Rregullativ të Ujit, KRU “Mitrovica” nuk kishte kompetencë për ndonjë ndryshim eventual, për më shumë ata nuk ishin në dijeni që një raporti i tillë ishte i publikuar, kjo pasi komplet menaxhmenti i kompanisë ishin të rinjë nga koha kur është kryer auditimi.

Si rezultat i mungesës së bashkëpunimit, nuk kemi pasur mundësi të bëjmë një vlerësim të drejtpërdrejtë për të konstatuar nëse ka pasur ndryshime pozitive apo përparim në zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Mungesa e bashkëpunimit dhe e transparencës në këtë proces e bën të vështirë vlerësimin objektiv të gjendjes aktuale dhe ngrit çështje serioze për nivelin e angazhimit institucional në adresimin e çështjeve të evidentuara me auditim.

Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore

Subjektet e përfshira në këtë auditim ku gjithsej kemi dhënë 16 rekomandime ishin: Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës (Inspektorati Sanitar) si dhe në komunat: Prishtinë, Ferizaj dhe Vushtri.

²² SNISA 3000 – standardi 146

Në mesin e ndryshimeve që kishte bërë MASHT pas publikimit të raportit kishte hartuar “Udhëzuesin për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore” ku në kapitullin 3.6 specifikohet pjesa e mirëmbajtjes. Po ashtu, gjatë periudhës së pandemisë, Ministria kishte hartuar dokumente të veçanta të cilat lidheshin me pastrimin dhe dezinfektimin e shkollave.

Komuna e Ferizajit na ka dëshmuar për ndryshimet pozitive lidhur me mirëmbajtjen objekteve shkollore. Ndërtesa e shkollës “Gjon Serreçi” është bërë pjesë e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme. Si rezultat i kësaj nxënësit janë zhvendosur në një objekt tjetër shkollor. Për të siguruar vazhdimësinë e mësimit, komuna ishte angazhuar që ndërtimi i objektit të ri shkollor të përfundohej brenda një afati sa më të arsyeshëm dhe nxënësit të barteshin në objektin e ri.

Sfidë për përmirësimin e kushteve për nxënësit është furnizimi me inventar për shkolla. Një nga shkollat e reja të ndërtuara nuk ka arritur të funksionalizohet si rezultat i mos furnizimit me kohë me inventarë, kjo për faktin që kontratat e centralizuara shkaktojnë probleme në furnizim.

Komuna e Vushtrrisë ka ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e kushteve në shkollat publike, veçanërisht në shkollën “SHMU-1” e cila është evidentuar si shembull i mirë i mirëmbajtjes. Këto veprime janë ndërmarrë si rezultat i gjetjeve të raportit sanitar dhe nevojës për përmirësime infrastrukurore. Në këtë shkollë janë realizuar investime në infrastrukturën teknologjike, si pajisja me projektorë dhe përfshirja në iniciativën komunale për digjitalizimin e shkollave, që ka përfshirë laptopë dhe tabela digjitale. Gjithashtu, SHMU-1 është dalluar për praktikën e mira mjedisore përmes sistemit të klasifikimit dhe riciklimit të mbetjeve, duke reflektuar një qasje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme ndaj edukimit dhe ambientit. Këto të dhëna dëshmojnë një angazhim të qartë institucional për përmirësimin e kushteve të nxënësit dhe mësimdhënies.

Komuna e Prishtinës nuk na ka ofruar dëshmi lidhur me ndryshimet në shkolla. Për shkak të mungesës së dëshmive të ofruara nga Komuna e Prishtinës, kemi realizuar një vizitë në shkollën “Ismail Qemali” ku jemi informuar se që nga viti 2019 janë kryer disa renovime nga Drejtoria e Shkollës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit. Këto ndërhyrje përfshijnë renovimin e dyshemesë në vitin 2019, intervenime në disa nyje sanitare, si dhe renovimin e banjove në aneksin e ri të shkollës. Megjithatë, pavarësisht këtyre përmirësimeve, objekti i shkollës ende nuk ofron kushte adekuate për zhvillimin e mësimit. Kjo është veçanërisht shqetësuese në katin përdhës (bodrumin) të shkollës, ku disa klasa janë të vendosura dhe ku korridori ishte i mbuluar me ujë gjatë vizitës sonë.

Lidhur me rekomandimin që i dedikohej Inspektoratit Sanitar, i cili në kohën e auditimit vepronte në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, vlerësimi i zbatimit të tij tashmë nuk është i matshëm, për shkak të ndryshimeve institucionale që kanë ndodhur në funksionimin e këtij inspektorati. Aktualisht, kompetencat për inspektimet sanitare janë transferuar nga AUV te Ministria e Shëndetësisë, e cila ka marrë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e kushteve higjeno-sanitare në institucionet publike, përfshirë shkolla.

Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit

Në këtë auditim janë përfshirë tri institucione qendrore, për të cilat janë dhënë gjithsej tetë rekomandime: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Administratës Publike (tutje MAP) dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (tutje MKRS).

MAP dhe MKRS kishin marr hapa konkret për përmirësimin e qartësisë së memorandumeve të mirëkuptimit në bashkëpunim me ministrinë tjera dhe komunat, gjatë periudhës 2019-2024. Përveç kësaj, është vërejtur progres në shkëputjen e kontratave dhe ekzekutimin e penalltive ndaj operatoreve ekonomik të papërgjegjshëm, si dhe në realizimin me kohë të pranimeve teknike të objekteve.

Është evidentuar se MAP dhe MKRS kanë ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e qartësisë së memorandumeve të mirëkuptimit në bashkëpunim me ministrinë e tjera dhe komunat gjatë periudhës 2019-2024. Për më tepër, është vërejtur përparim i dukshëm në shkëputjen e kontratave dhe zbatimin e penalltive ndaj operatorëve ekonomikë të papërgjegjshëm, si dhe në realizimin në kohë të pranimeve teknike të objekteve. Si rezultat i këtyre masave, është rritur përgjegjshmëria kontraktuale, është përmirësuar efikasiteti në menaxhimin e projekteve investive dhe janë reduktuar rreziqet e keqpërdorimit të fondeve publike.

Sa i përket MASHT-it nuk na ka ofruar dëshmitë lidhur me ndryshimet. Megjithatë, në një intervistë na kanë njoftuar që gjendja ka ndryshime pozitive, duke filluar me ndryshimet në memorandume, pajisjen me leje ndërtimore para nënshkrimit të kontratës si dhe në rastin e vonesave të realizimit të punëve kanë filluar me ekzekutimin e penalltive.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson se MAP dhe MKRS kanë bërë përparime të rëndësishme në përmirësimin e menaxhimit të kontratave publike dhe zbatimin e penalltive. Megjithatë, MASHT nuk ka siguruar dëshmi të mjaftueshme për zbatimin e ndryshimeve, edhe pse ka raportuar për përmirësime pozitive.

Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje

Komunat e përfshira në këtë auditim, ku janë dhënë gjithsej pesë rekomandime, ishin: Mitrovica, Suhareka, Vitia dhe Istogu. Komuna e Suharekës nuk ka ofruar dëshmi edhe pas takimeve dhe kërkesave tona, ndërsa me Komunën e Vitisë nuk është arritur të mbahet takim. Nga ana tjetër, komunat e Mitrovicës dhe Istogut kanë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme pas vitit 2019 ndarjen e tenderëve në lloje.

Komuna e Mitrovicës ka ndarë tenderët në lloje për kontrata të ndryshme, përfshirë rregullimin e objekteve shkollore, i ndarë në tre lloje, transportin e nxënësve në shtatë lloje, furnizimin me barna për Qendrat e Mjekësisë Familjare, si dhe mirëmbajtjen e rrugëve verore-dimërore. Ndërkohë, Komuna e Istogut ka aplikuar ndarjen e tenderëve në lloje

për ndërtimin e Ambullantës në dy llote, mirëmbajtjen e objekteve të administratës në tre llote, si dhe për mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve të ndryshme.

Si rezultat i këtyre masave, është përmirësuar përgjegjshmëria kontraktuale, është rritur efikasiteti në menaxhimin e projekteve investive dhe janë reduktuar rreziqet e keqpërdorimit të fondeve publike.

5. Konkluzionet

Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës reflekton një mungesë të angazhimit institucional dhe llogaridhënie të dobët. Nga 199 rekomandime të dhëna, vetëm 51 rekomandime janë zbatuar apo 25%, përderisa 111 apo 55% e rekomandimeve nuk kanë filluar ende zbatimin. Për 31 rekomandime apo 16% të tyre nuk ka qenë e mundur të bëhet vlerësimi për shkak të mungesës së përgjigjeve nga subjektet e audituara respektivisht kufizimit të fushëveprimit, ndërsa 6 rekomandime apo 4 % janë në proces të zbatimit. Kjo gjendje ngrit shqetësime në lidhje me efikasitetin e procesit të auditimit dhe ndikimin e tij real në menaxhimin publik.

Mungesa e letër – konfirmimeve dhe planeve të veprimit është tregues i drejtpërdrejtë i një bashkëpunimit të mangët me ZKA, por edhe mungesë të strukturave të brendshme funksionale për të menaxhuar dhe zbatuar rekomandimet. Vetëm 12 nga 36 subjekte të audituara kanë dorëzuar letër-konfirmime, ndërsa plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve janë dorëzuar vetëm nga 12 prej tyre. Tre raporte të auditimit nuk ishin të shoqëruara me asnjë plan veprimi, ndërsa pesë raporte kishin plane të pjesshme për zbatimin e rekomandimeve.

Megjithëse disa institucione kanë shënuar përmirësime në aktivitetet e tyre pas auditimit, këto ndryshime nuk janë gjithmonë rezultat i drejtpërdrejtë i rekomandimeve të ZKA-së. Në disa raste, përmirësimet kanë ardhur si rrjedhojë e reformave të brendshme, politikave të reja institucionale apo alokimeve të mëvonshme buxhetore. Kjo situatë e bën të vështirë të matet ndikimi i vërtetë i auditimeve të performancës dhe tregon nevojën për një sistem të qartë të ndërlidhjes së rekomandimeve me veprimet përkatëse.

Në nivelin individual të raporteve, disa institucione kanë demonstruar progres gjatë periudhës 2019-2024, zbatimin efektiv të rekomandimeve dhe përmirësime të dukshme të performancës. Raportet për “Sigurinë e Ushqimit” dhe “Kontrollin e cilësisë së derivateve” përfaqësojnë praktika të mira ku institucionet e audituara kanë dorëzuar plane të plota të veprimit dhe kanë ndërmarrë hapa të qarta për zbatim. Dogana e Kosovës ka përmirësuar pajisjet teknologjike si pjesë e zbatimit të rekomandimeve ndërsa Policia e Kosovës ka ndërmarrë hapa konkretë për të rritur sigurinë në trafik. Megjithatë, në një pjesë të konsiderueshme të institucioneve, procesi i zbatimit nuk ka mundur të vlerësohet për shkak të mungesës së komunikimit dhe dokumentacionit të nevojshëm.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë qartë se institucionet e audituara nuk kanë treguar përkushtim të mjaftueshëm në zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Rrjedhimisht, mesazhi që synohet të përcillet përmes kësaj pjese është nevoja për një përkushtim më të madh dhe një bashkëpunim më të strukturuar ndërmjet subjekteve të audituara dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit. Kjo është thelbësore për të siguruar që rekomandimet të mos mbeten vetëm në letër, por të zbatohen në praktikë, me qëllim përmirësimin e performancës institucionale dhe forcimin e llogaridhënies publike.

Shtojca I. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Motivi i Auditimit

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga raportet individuale të auditimit të performancës bëhet përmes vlerësimeve apo auditimeve të veçanta, të cilat njihen edhe si “faza e përcjelljes”. Pas këtij procesi nxjerrën edhe rezultatet e zbatimit të rekomandimeve. Përmes auditimeve të performancës, ZKA-ja i ka ofruar Kuvendit dhe subjekteve të audituara rekomandime të dobishme që të përmirësojnë dhe rrisin ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në sektorë të rëndësishëm si: financa publike, mjedis, sistemet e teknologjisë informative, prokurimi publik. Rekomandimet e auditimit të performancës kanë përfshirë si nivelin e qeverisjes qendrore ashtu edhe atë lokale. Mirëpo, niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet i ulët. Ndër arsyet për zbatimin e ultë të rekomandimeve janë edhe mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, si dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre, janë ndër shkaktarët kryesorë për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse, ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë të tyre.

Pyetjet e auditimit

Për t’iu përgjigjur objektivës së auditimit, kemi formuluar pyetjet dhe nën-pyetjet në vijim:

- 1 A janë dërguar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe a janë zbatuar rekomandimet nga subjektet e audituara?**
 - 1.1 A janë dorëzuar me kohë letër konfirmimet dhe planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve?
 - 1.2 A janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të auditimit sipas prioritetit të përcaktuar në plan të veprimit?
- 2 A kanë arritur rekomandimet përmirësimin e gjendjes në subjektin e audituar?**
 - 2.1 A kanë zbatuar subjektet e audituara ndryshimet në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit?
 - 2.2 Cila është gjendja në subjekte të audituara pas publikimit të raportit të auditimit?

Kriteret e auditimit:

Për të verifikuar këtë, kemi vënë kriteret e përmbledhura:

- Pas publikimit të raportit të auditimit subjektet e audituara duhet të hartojnë planet e veprimit (aktiviteteve) për zbatim të rekomandimeve të dhëna dhe të sigurohen se ato zbatohen sipas afateve kohore të specifikuara në plan²³.
- Në një periudhe të arsyeshme kohore pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, subjekti i audituar duhet të siguroj progres në përputhje me zotimet në plan të veprimit²⁴.
- Subjekti i audituar duhet të vë në funksion një mekanizëm formal për të adresuar secilin rekomandim. Përmes këtij mekanizmi duhet të sigurohet gjurmimi i secilit rekomandim derisa adresimi të përfundojë apo të arrihet zgjidhja e problemit²⁵.
- Subjekti i audituar nuk kufizohet vetëm me zbatim të rekomandimeve, por mund të fokusohet në trajtimin e problemeve në mënyrë adekuate dhe zgjidhje të problemeve pas periudhe të arsyeshme²⁶.

Metodologjia e Auditimit

Qasja jonë për këtë auditim përcjellës do të përfshijë një varg teknikash për të marrë dëshmi dhe siguri të auditimit përcjellës, këto përfshijnë: pyetësorët e dërguar në institucione, intervistimi i zyrtarëve përkatës (sipas nevojës), analizimi i dokumenteve relevante dhe testimet e nevojshme. Më konkretisht do të fokusohemi në:

- Analizimin e letër konfirmimeve dhe planeve të dorëzuara të veprimit;
- Takime dhe intervista me zyrtarët përgjegjës në institucionet të cilat nuk kanë dorëzuar plane të veprimit;
- Takime dhe intervista me zyrtarët përgjegjës lidhur me pyetësorin dhe veprimet e ndërmarra të dokumentuara të entitetit;
- Hartimin e pyetësorit dhe analizimin e përgjigjeve të pranuar nga pyetësori i dërguar përmes së cilit palët përgjegjëse na informojnë me shkrim lidhur me aktivitetet që janë ndërmarra për të adresuar problemet e prezantuara në raportin e auditimit;
- Analizimin e dokumenteve/dëshmimeve të pranuar që dëshmojnë aktivitetet e ndërmarra nga ana e subjektit për zbatim të rekomandimeve të dhëna sipas afatit kohor të përcaktuar në planin e veprimit;
- Komunikimin me subjektet e përfshira në auditime, telefonata dhe email konfirmues lidhur me gjendjen faktike në subjekt;
- Vizita për të mbledhur informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga subjekti i audituara.

²³ Udhëzuesi për përcjellje të zbatimit të rekomandimeve, ZKA

²⁴ SNISA 3200, faqe 34/35,

²⁵ <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1002/9781119529132.ch14>

²⁶ SNISA 3000 – standardi 146

Fushëveprimi dhe kufizimet e këtij auditimi

Ky auditim përcjellës për bazë do të ketë raportet e auditimit të performancës të publikuara në vitin 2019. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur institucionet e përfshira në auditim, të ndara sipas raporteve të auditimit të publikuara brenda këtij viti.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur subjektet e përfshira në auditim për dhjetë raporte të auditimit të performancës.

Tabela 3. Raportet e auditimit dhe subjektet e përfshira në auditim

	<i>Raporti i Auditimit</i>	<i>Institucionet e Audituar</i>
1	<i>Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020 në sektorin e arsimit dhe infrastrukturës</i>	Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
2	<i>Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit</i>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Autoriteti Rregullativ për Shërbime të Ujit, KRU Mitrovica, KRU "Hidrojeni Jugor", KRU "Hidrodrini", ngrohitorja qendrore "Termokos" dhe ngrohitorja qendrore "Gjakova".
3	<i>Siguria në trafikun rrugor</i>	Policia e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit dhe Komuna e Prishtinës
4	<i>Siguria e Ushqimit – Rast studimi: produktet e mishit dhe të gurit</i>	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë Zyrat Regjionale të Mitrovicës dhe Gjilanit si dhe pikat inspektuese Mitrovicë dhe Prizren.
5	<i>Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore</i>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe komunitat: Prishtinë, Ferizaj dhe Vushtrri.
6	<i>Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit</i>	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
7	<i>Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve</i>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati dhe Dogana e Kosovës
8	<i>Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje</i>	Komunitat: Mitrovicë, Suharekë, Viti dhe Istog
9	<i>Procesi i menaxhimi të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë</i>	Zyra e Kryeministrit , Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Ferizajt
10	<i>Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë</i>	Dogana e Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Tre nga raportet e publikuara në vitin 2019 nuk do të jenë mostër e auditimit.1. Projektet e financuara nga grantet e DEMOS 2019” nuk do të jetë mostër, sepse bashkëpunimi me Helvetas/DEMOS është në vazhdimësi nga viti 2018 e deri më tani dhe kryhen auditime çdo vit. 2. Zhvillimi i Kapaciteteve në Procesin e Bërjes së Politikave dhe Koordinimit, nuk do jetë mostër, sepse projekti në Zyrën e Kryeministrit ka përfunduar, pra nuk ka çfare të vlerësohet dhe raporti 3. Analizë/Tregues të performancës për nivelin lokal qeverisës për vitin-2018”, ky dokument ishte publikuar në vitin 2019 si analizë lidhur me treguesit e performancës komunale dhe nuk ka rekomandime që do të mund të vlerësohen sikurse tek raportet e zakonshme të performancës.

ZKA gjatë kryerjes së auditimit kishte fushëveprim të kufizuar për raportet: Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit, Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë dhe Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje. Ky kufizim përfshinte 31 rekomandime apo 16% të rekomandimeve të dhëna në vitin 2019 që nuk kanë arritë të vlerësohen.

Tabela 4: Raportet e auditimit dhe numri i subjekteve sipas niveleve

<i>Nr.</i>	<i>Auditimet e Performancës</i>	<i>Subjektet</i>	<i>NQ</i>	<i>NL</i>	<i>NP</i>
1	<i>Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020 në sektorin e arsimit dhe infrastrukturës</i>	3	3		
2	<i>Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit</i>	7	2		5
3	<i>Siguria në trafikun rrugor</i>	3	2	1	
4	<i>Siguria e Ushqimit – Rast studimi: produktet e mishit dhe të gurit</i>	5	1	4	
5	<i>Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore</i>	5	2	3	
6	<i>Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit</i>	3	3		
7	<i>Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve</i>	2	2		
8	<i>Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje</i>	4		4	
9	<i>Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë</i>	5	2	3	
10	<i>Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë</i>	4	4		

Për të vlerësuar numrin e rekomandimeve të zbatuara, ne kemi përzgjedhur 10 nga 13 raportet e publikuara. Numri i subjekteve që do të përfshihen në procesin e vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve auditim është 41 prej të cilave 21 institucione qendrore (Ministri dhe Agjenci vartëse), 15 komuna dhe pesë ndërmarrje publike.

Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant

Përcjellja e rekomandimeve dhe raportimi mbi rezultatet e zbatimit të tyre janë rregulluar me Udhëzuesin për Përcjelljen e Rekomandimeve të Auditimit të Performancës. Ky dokument shërben si një manual që duhet ndjekur për përcjelljen e rekomandimeve të auditimit të performancës, duke vendosur standarde dhe hapa për raportim të qëndrueshëm dhe të organizuar.

Përgjegjësia për përcjelljen e rekomandimeve të auditimit dhe raportimin mbi rezultatet e zbatimit i takon udhëheqësit të ekipit të auditimit ose një zyrtari tjetër të ZKA-së, të caktuar nga Drejtori i Departamentit të Auditimit në koordinim me Auditorin e Përgjithshme dhe në harmoni me planin vjetor të auditimit. Ky proces është një pjesë kyçe në sigurimin e ndikimit dhe efektivitetin e rekomandimeve të dhëna të auditimit.


Ekipi i auditimit i ngarkuar për përcjelljen dhe raportimin e rezultateve të zbatimit të rekomandimeve, përveç punës në entitete për ndjekjen e tyre, bashkëpunon edhe me Departamentin e Komunikimit dhe zyrtarin ndërlidhës me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky koordinim siguron dhënie të saktë të të dhënave mbi raportet e shqyrtuara, qoftë në komisionet parlamentare apo në Kuvend nga deputetët. Ky aktivitet siguron informim lidhur me rëndësinë e auditimit dhe përgjegjësinë shtesë për implementim të rekomandimeve nga entitetet e audituara.

Gjatë vitit 2019 në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike janë shqyrtuar gjithsej 36 raporte të auditimit të ZKA-së, 10 prej tyre janë rekomanduar për shqyrtim në seancë plenare të kuvendit. Nga raportet e divizionit të performancës është shqyrtuar raporti i auditimit: “*Procesi i Menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në Sektorin e Bujqësisë*”.

Meqenëse periudha e publikimit të raporteve të vitit 2019 korrespondon me vitin pandemik, kjo është arsyeja pse nga gjithsej 130 raporte të dërguara në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë shqyrtuar vetëm 37 prej tyre në komisionin parlamentar.

Hapat që duhet ndjekur në auditimin përcjellës janë paraqitur në diagramin numër 1.

Diagrami 1 Procesi i auditimit përcjellës



Shtojca II. Tabela me rekomandimet për të cilat nuk kemi marrë përgjigje/kufizim fushëveprimi

	Rekomandimet	Entiteti përgjegjës	Statusi i rekomandimit
<i>Sistemi Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësllësit</i>	Në bashkëpunim me institucionet përkatëse të identifikojnë konsumatorët që jetojnë me asistencë sociale, dhe përmes autoritetit përkatës t'u paguaj shpenzimet për shërbimet e ujit dhe energjisë termike	Qeveria e Republikës së Kosovës	S'kemi pranuar përgjigje
	Të përcaktohen bartësit e shpenzimeve të ujësllësit për objektet e kultit dhe në bashkëpunim me institucionet relevante të kompensohet vlera e shpenzimeve.	Qeveria e Republikës së Kosovës	S'kemi pranuar përgjigje
	Të siguroj se janë duke u zbatuar kuota më të ulta të tarifave të energjisë elektrike për zonat e rrezikuara mjedisore për të eliminuar barren e padrejtë për qytetarët e këtyre zonave.	Qeveria e Republikës së Kosovës	S'kemi pranuar përgjigje
	Llogaritë e arkëtueshme në emër të konsumatorëve që jetojnë me asistencë sociale dhe që duhet të kompensohen nga institucionet përkatëse, të mos përfshihen në vlerën totale të borxhit të keq	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar përgjigje
	Tarifa fikse për shërbime publike të përfshihet në strukturën tarifore në rastet kur bazuar në analiza paraprake të dokumentuara mirë, konsiderohet e arsyeshme	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar përgjigje
	Të sigurohet pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në konsultime publike e të gjitha palëve të interesit dhe me fokus të veçantë në pjesëmarrjen e qytetarëve njëherit duke zgjeruar konsultimet përmes mediave elektronike	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar përgjigje
	Të thjeshtësohen draft raportet për të Hyrat e Lejuara Maksimale të publikuara për konsultime publike me qëllim që të kuptohen më mirë nga konsumatorët – publiku i gjërë të cilëve ju dedikohet konsultimi publik	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar përgjigje
	Aprovimi i humbjeve të kompanive ofruese të shërbimeve të jetë i bazuar në një metodologji unike gjatë procesit të vendosjes së tarifave dhe të jenë të bazuara në analiza të dokumentuara, me qëllim që barra financiare të jetë e balancuar nëpër vite	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar përgjigje
	Niveli i humbjeve të aprovuara të ketë elemente të caqeve stimuluese si mekanizma motivues për përmirësimin e performancës së kompanive ofruese të shërbimeve në drejtim të zvogëlimit të humbjeve.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar përgjigje
Aprovimi i investimeve kapitale të financuara përmes tarifave të jetë i analizuar mirë duke synuar rezultate konkrete në zgjerimin e shërbimeve, po ashtu edhe në zvogëlimin e humbjeve teknike.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar përgjigje	

ARRU të konsideroj kalkulimin e kostove të ujit të trajtuar me shumicë me theks të veçantë të kostove të distribuimit në mënyrë që të arrijnë përcaktimin e një tarife më të saktë.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigje
: Tarifat e shërbimeve të ujësjellësit dhe energjisë termike të kalkuloohen bazuar në konsumin e shërbimeve të matura me matës të kalibruar	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigje
Të hartohen rregullore të cilat përcaktojnë sasi dhe natyrën e investimeve kapitale të financuara përmes tarifave të cilat janë të pranueshme dhe të bazuara në analiza duke pasur parasysh vlerën e aseteve ekzistuese dhe nevojën për rritje të bazës së aseteve	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigje
Niveli i lejimeve për borxhet e kqija të energjisë elektrike dhe termike në strukturën tarifore të aprovet duke pasur parasysh nivelin e pjesëmarrjes së borxhit të keq brenda llogarive të arkëtueshme aktuale.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigje
Aprovimi i investimeve kapitale nëpërmes tarifës të bëhet vetëm në situatat kur ka një sqarim të qartë dhe kur janë shterrur të gjitha mundësitë e financimit nga fitimi i akumuluar/gjeneruar, financimi i aseteve të vjetra nga shpenzimet e zhvlerësimit apo nga fonde tjera në të cilat mund të ketë qasje kompania.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigje
Të gjitha kostot e aprovuara të kenë bashkangjitur dëshmi përkatëse të cilat dokumentojnë investimin e kryer si dhe nevojën për ato investime.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigje
Zyrat rregullatore të krijojnë ndarje të qartë të aseteve të financuara përmes donacioneve dhe aseteve të financuara nga burimet vetanake duke krijuar edhe norma deri sa mund të rriten asetet vetanake gjatë një procesi rregullator.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigje

*Procesi i
menaxhimit të
granteve dhe
subvencioneve në
sektorin e bujqësisë*

Shpenzimet e zhvlerësimit të kalkuloohen vetëm në vlerën neto të aseteve ekzistuese, të cilat janë në funksion për gjenerimin e shërbimeve dhe të konsiderohen vetëm për mirëmbajtjen, respektivisht zëvendësimin e aseteve të vjetra.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigjje
Të analizohet edhe një herë arsyeshmëria e vendimit për aprovimin e investimeve kapitale nëpërmes tarifave për të ndërtuar objektin e ri të drejtorisë dhe administratës së NQ 'Termokosi'	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigjje
Autoritetet rregullatore të kujdesen që fitimi i realizuar nga kompanitë ofruese të shërbimeve publike të mos jetë më i lartë se fitimi i aprovuar - kthimi i lejuar në bazën e rregulluar të aseteve.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigjje
ZRRE të kujdeset që shpenzimet të cilat nuk kanë arsytim të qartë dhe aplikueshmëri në procesin e ofrimit të shërbimeve të mos aprovohen. Shpenzimet të cilat iu janë bashkangjitur tarifave në të kaluarën, si rasti i mazutit nga ky auditim dhe që nuk kanë ndodhur realisht, në rregullimet e ardhshme të kompenzohen konsumatorët në vlerën totale të cilët kanë paguar për këto kosto të pandodhura.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigjje
Zyrat rregullatore të mos aprovjnë rritje të kostove të personelit me arsytetime të pa bazuara dhe pa argumentuara mirë të cilat rrisin tarifat e shërbimeve.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigjje
Zyrat rregullatore gjatë shqyrtimeve tarifore të aplikojnë norma të inflacionit bazuar në analiza përkatëse nga institucionet përkatëse të cilat reflektojnë normën e inflacionit në vend, respektivisht sqarime të argumentuara nëse veprimet janë të ndryshme.	Rekomandimet për Autoritetet Rregullative	S'kemi pranuar pergjigjje
Të përcaktoj rolin dhe përgjegjësitë e përdoruesve për aplikacionet që përdoren për vlerësimin e granteve dhe subvencioneve dhe qasja të mundësohet sipas përgjegjësive të përcaktuara; dhe	Rekomandimet për AZhB	S'kemi pranuar pergjigjje
Të hartoj plane për kontrolle ex-post duke vlerësuar rreziqet sipas masave të përcaktuara në program si dhe të kryej kontrolle pas investimit për të vlerësuar arritjen e rezultateve nga përfituesit e fondeve për sektorin e bujqësisë.	Rekomandimet për AZhB	S'kemi pranuar pergjigjje

Të zhvillojnë analizë të tregut për të identifikuar OE-të relevant, të mbledhin informacion për gjendjen në treg, duke i kategorizuar OE-të në ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha. Kësisoj, AK-të duhet të sigurojnë informacion të mjaftueshëm mbi të cilin do ta bazojnë vendimin për ndarje të tenderit në lloje apo të zhvillojnë tender të pandarë. Të dokumentojnë vendimin për ndarje të tenderit në lloje përfshirë objektivat që AK-të synojnë t'i arrijnë;	Rekomandimet për komunën e Vitisë	S'kemi pranuar pergjigje
Kufizimet në tender të vendosen bazuar në analiza paraprake në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca apo të mos rriten çmimet;	Rekomandimet për komunën e Vitisë	S'kemi pranuar pergjigje
Të analizohen efektet e aktivitetit të prokurimit të ndarë në lloje duke specifikuar qartë cilat objektiva të ndarjes së tenderit janë arritur plotësisht, pjesërisht apo nuk janë arritur fare. Mësimet e nxjerra nga analiza e efekteve të prokurimit t'i shfrytëzojnë për prokurimet e ardhshme	Rekomandimet për komunën e Vitisë	S'kemi pranuar pergjigje
Të dizajnojnë tenderët në atë mënyrë që të arrijnë objektivat e synuara. Të merren parasysh të gjithë skenarët e mundshëm, bazuar në informacionet që dalin nga analiza e tregut, përpara se të merret vendimi për llojin e kufizimit (nëse zbatohet) që do të zbatohet në çdo tender të ndarë në lloje; dhe	Rekomandimet për komunën e Vitisë	S'kemi pranuar pergjigje
Për të arritur objektivin e efikasitetit në zbatim të projekteve, komunat të sigurojnë fonde të mjaftueshme që mbulojnë tërë vlerën e projektit, para se të nisin aktivitetin e prokurimit	Rekomandimet për komunën e Vitisë	S'kemi pranuar pergjigje

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës